



FACT SHEET - TUBERCULOSIS



Landessanitätsdirektion für Tirol

Albanian

Mirëseardhja

Përshëndetje. Do të doja t'ju jepja informacion rreth një sëmundje të quajtur tuberkuloz. Emra të tjerë për sëmundjen janë TB ose historikisht njihet si veremi.

Kjo sëmundje prek miliona njerëz në mbarë botën çdo vit. Ka ndryshime të caktuara në vende të ndryshme për mënyrën se si është menaxhuar sëmundja. Kjo për shkak të faktit se njohuritë rreth tuberkulozit variojnë nga vendi në vend, por edhe se tuberkulozi është më i shpeshtë në disa vende se sa në të tjera. Përveç kësaj ka dhe diferenca në burimet njerëzore dhe financiare në trajtimin e tuberkulozit. Prandaj, disa nga informacionet e treguara në këtë video mund të mos jenë të rëndësishme ose të vërteta për situatën tuaj personale. Megjithatë, të gjithë pacientët me tuberkuloz kanë një gjë të përbashkët: sëmundja është një eksperiencë e veçantë. Ajo ndryshon jetën e gati të gjithë atyre që janë të prekur dhe sëmurë. Informacioni i mëposhtëm mund t'ju ndihmojë të kuptoni se kush e shkakton tuberkulozin, si diagnostikohet sëmundja dhe kush është trajtimi i nevojshëm. Në rast se ju jeni të prekur nga kjo sëmundje, unë sinjorisht shpresoj të bëheni mirë sa më shpejt.

Simptomat

Përgjigja inflamatore në trup shkakton simptomat tipike të tuberkulozit. Sëmundja përparon shumë ngadalë. Prandaj, simptomat mund të persistojnë për shumë muaj përpara se të vendosni për tu vizituar te një mjek. Simptomat karakteristike janë kollë për një kohë të gjatë, temperaturë, djersitje natën kur flini dhe rënie në peshë. Disa njerëz duhet të ndryshojnë carcafin disa herë natën, sepse ata djersisin shumë. Shumë të tjerë vënë re rënien në peshë deri në disa kilogramë.

Ju mund të ndihmoni miqtë dhe familjen tuaj duke u mësuar atyre shenjat tipike të sëmundjes. Tregoni atyre se gjithkush duhet të kontrollohet për tuberkuloz kur vërejnë ankesa tipike të tilla si kollë për disa javë, temperaturë, djersitje natën dhe rënie të paqëllimshme në peshë.

Shanset e shërimit

Shansi i shërimit për njerëzit me tuberkuloz plotësisht të ndjeshëm është i shkëlqyer. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që medikamentet të merren në mënyrë të vazhdueshme për gjithë kohëzgjatjen e trajtimit. Në qoftë se ju do të ndërprisni marrjen e medikamenteve shumë herët ose ju nuk do i merrni ato rregullisht ekziston rreziku që sëmundja të rikthehet dhe mund të jetë shumë më e vështirë për ta trajtuar. Kjo kohë e gjatë e trajtimit është e nevojshme, edhe pse pas disa javësh ju mund të filloni të ndiheni të shëndetshëm dhe analizat laboratorike nuk zbulojnë baktere të tuberkulozit. Kjo për shkak se një numër i vogël i këtyre organizmave vazhdojnë të jenë ende brenda trupit tuaj. Këto baktere „të fshehura“ do të eliminohen vetëm nëse trajtimi ka kohëzgjatjen e saktë të rekomanduar nga mjeku juaj. Ndalimi i pirjes së duhanit është një mënyrë tjetër përmes të cilit ju mund të përmirësoni shanset për një shërim. Ka disa forma të tuberkulozit të tilla si tuberkulozi që prek sistemin nervor qendror (trurin dhe membranat të cilat e rrethojnë atë) të cilat janë shumë të rrezikshme madje edhe vdekjeprurëse në të cilat diagnoza dhe trajtimi i hershëm janë jashtëzakonisht të rëndësishme për një rezultat të mirë. Gjendja e imunitetit dhe disa sëmundje si infeksioni i imunodeficiencës humane (HIV) si dhe sëmundje të tjera ndikojnë gjithashtu në rezultatin e shërimit. Njerëzit të cilët kanë tuberkuloz rezistent janë më të vështirë për tu trajtuar dhe shanset për shërim janë më të pakta. Kjo është për shkak të faktit se mundësitë e trajtimit janë të kufizuara dhe medikamentet që mjeku rekomandon nuk janë aq efektive tek bakteret dhe ka shumë mundësi të kenë efekte negative. Përveç kësaj, në disa vende, disa prej medikamenteve mund të mos jenë aspak të disponueshme. Kjo është një arsye pse shanset për shërim në rastin e tuberkulozit rezistent ndaj shumë medikamenteve ndryshojnë midis vendeve.

Parandalimi i transmetimit

Për sa kohë që bakteret nxirren me kollë, individit duhet të konsiderohet infektues për të tjerët. Kjo është arsyeja pse ju duhet të mbuloni gojën dhe hundën me një shami kur kolliteni ose tështini. Mos e ndaj me të tjerët shaminë e përdorur. Hidhini shamitë tuaja të përdorura në një kosh mbeturinash, mos i mbani në xhep. Nëse nuk keni një shami, kollituni apo tështini në mëngën tuaj të sipërme ose në bërryl, jo tek duart tuaja. Gjithashtu, mos pështyni në tokë, por në një shami.

Në shumë mjedise, pacientëve infektues mund tju kërkohet që të veshin një maskë mbrojtëse fytyre duke mbuluar gojën dhe hundën kur takohen me të tjerët, ballë për ballë apo në ambiente të mbyllura. Duhet gjithashtu të hapni rregullisht dritaret e dhomës tuaj për të lejuar një ajrosje të mjaftueshme dhe një ekspozim ndaj rrezeve të diellit. Është e rëndësishme të ajrosni sa më shpesh dhomën tuaj pasi bakteret e vogla mund të rrinë pezull në ajër për shumë orë dhe të infektojnë të tjerët. Për këtë arsye, njerëzit që kanë kontakt me ju në ambiente të mbyllura këshillohen të veshin maska mbrojtëse gjithashtu. Këto duhet të jenë maska të licencuara që plotësojnë kriteret N95 ose standardet FFP2 ose N95. Maskat parandalojnë thithjen e baktereve dhe ofrojnë mbrojtje të mirë për miqtë dhe të afërmit tuaj që ju vizitojnë.

Izolimi

Për sa kohë ju infektoni të tjerët, do t'ju kërkohet të ndiqni disa rregulla me qëllim për të parandaluar kalimin e infeksionit të tjerët. Në disa vende, nuk do t'ju lejohet të largoheni nga dhoma juaj në spital për disa kohë. Gjithashtu dalja nga spitali nuk lejohet në shumë vende për aq kohë sa ju nxirrni baktere me kollw. Ju duhet të siguroni të gjitha gjërat që keni nevojw në dhomën tuaj të spitalit.

Në vende të tjera, veçanërisht në zonat ku shumë njerëz vuajnë nga tuberkulozi, pacientët nuk mbahen domosdoshmërisht të izoluar në një dhomë. Ato mund të lejohen të lëvizin jashtë ose mund të dërgohen në shtëpi. Megjithatë, një rregull aplikohet universalisht:

Nëse ju jeni i infektuar, ju dhe vizitorët tuaj duhet të mbajnë maska mbrojtëse fytyre në ambiente të mbyllura për të shmangur rrezikun e infektimit. Kjo vlen edhe kur ju largoheni nga dhoma vetëm për një kohë të shkurtër – për shembull për një ekzaminim. Ju duhet të jeni të sigurtë që maska mbulon si hundën dhe gojën njëkohësisht. Ajo duhet të jetë ngjeshur në mënyrë të përshtatëshme në fytyrën tuaj për të parandaluar çdo dalje anësore të ajrit duke anashkaluar maskën. Mjeku apo infermierja mund të ju jap udhëzime se si të përdorni maska të cilat quhen edhe maska filtruese tw grimcave.

Informacion i përgjithshëm rreth trajtimit

Tuberkulozi mund të trajtohet me një kombinim të veçantë të barnave antibiotikë. Në shumicën e rasteve, sëmundja mund të shërohet dhe nuk mbetet asgjë. Për fat të keq, trajtimi vazhdon për shumë muaj dhe kërkon shumë qëndrueshmëri. Ju do të keni nevojë për të marrë tableta për shumë muaj. Terapia me antibiotikë fillon me të ashtëquajturën fazë intensive për dy ose më shumë muaj. Gjatë kësaj periudhe do të trajtoheni me të paktën katër medikamente, ndërsa më pak medikamente janë të nevojshme gjatë muajve në vijim në atë që quhet faza e mbajtjes.

Për të lehtësuar këtë terapi të gjatë, në shumë vende janë në dispozicion të quajtur kombinime dozash fikse. Kjo do të thotë se ka 2-4 medikamente të kombinuara në një tabletë të vetme. Vende të tjera, megjithatë, nuk kanë qasje në këto tableta të kombinuara. Në këto vende, pacientët duhet të gëlltisnin disa tableta çdo ditë.

Edhe pse kjo mund të jetë e papërshtatshme, është shumë e rëndësishme që ju të merrni tabletat tuaj rregullisht. Nëse ju nuk i merrni tabletat rregullisht, trajtimi mund të mos jetë i suksesshëm. Bakteret do të fillojnë të shumohen përsëri dhe mund të bëhen rezistente ndaj antibiotikëve. Kjo çon në një trajtim edhe më të komplikuar dhe të zgjatur. Në rastin më të keq, sëmundja mund të bëhet e patrajtueshme dhe fatale.

Roli i pacientit në shërim

Ju mund të kontribuoni në shërimin tuaj me masa të thjeshta. Është e rëndësishme të mos pini duhan. Shërimi zgjat më shumë te duhanpirësit se te jo-duhanpirësit.

Ajri i pastër dhe ekspozimi ndaj rrezeve të diellit duket të jenë të dobishme. Duhet të ajrosni dhomën tuaj rregullisht. Faktori më i rëndësishëm është marrja e medikamenteve të përshkuara në mënyrë të rregullt.

Ju duhet të hiqni dorë nga drogat rekreative dhe alkooli. Çdo varësi ndaj alkoolit ose drogës mund të dëmtojë sistemin imunitar. Kërkoni ndihmë tek mjeku nëse mendoni se nuk mund të hiqni dot vetë dorë nga këto vese të pashëndetëshme. Kjo siguron që shërimi nga tuberkulozi të mund të arrihet sa më shpejtë të jetë e mundur.

Name der Bezirksverwaltungsbehörde:
(name of district administrative authority)

Name des Patienten:
(name of patient)

Geburtsdatum:
(date of birth)

Datum, Unterschrift
(date, signature)

Datum, Unterschrift
(date, signature)



App with text-to-speech function for Apple iOS and Android for
www.explaintb.org